



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.981/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “V...F...” Sh.P.K me seli në Gjilan, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, rivlerësim i shpenzimeve të transportit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2667/18, të datës 31.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit “V...F...” Sh.P.K me seli në Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2667/18, të datës 31.12.2020, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit “V...F...” Sh.P.K me seli në Gjilan, dhe mbetet në fuqi aktvendimi me nr.07.3/249-2014, të datës 09.10.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesën të aprovoj si të bazuar, ashtu

që kërkesëpadinë e paditësve ta provojë në tërësi si të bazuar, ose në alternativë të kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë e paditura edhe pse ankesën e ka pranuar me dt.10.02.2021.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjyimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.07.3/249-2014 të datës 09.10.2018 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë “V...F...” Sh.P.K me seli në Gjilan për rishqyrtimin e aktvendimit nr.05.1/048 i datës 31.01.2014 i lëshuar i Sektorit të Kontrollit Pas Importues si e pa bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor me datë 17.12.2020 në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit “V...F...” Sh.P.K me seli në Gjilan, dhe mbetet në fuqi aktvendimi me nr.07.3/249-2014, të datës 09.10.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga ekzaminimi i aktvendimit kontestues Gjykata ka vlerësuar si të drejtë konstatimin e të paditurës Dogana e Kosovës, Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve lidhur me veprimin e bazuar dhe të drejtë të Sektorit të Kontrollit Pas Importues në kuptim të rivlerësimit të shpenzimeve të transportit bazuar në faturat e gjetura tek subjekti “Shega Pro” dhe të pa deklaruar nga këtu paditësi në procedurë të zhdoganimit sipas

DUD-ave kontesutes. E Paditura ka verifikuar në ATK-ë, faturat e shpenzimeve të transportit të gjetura tek subjekti i tretë dhe të padeklaruara nga këtu paditësi, me ç'rast të njëjtat janë konstatuar si të deklaruara pranë ATK-së, pra janë reale në kuptim të vlerës dhe përmbajtjes së tyre. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi, ku nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se me aktin administrativ të kontestuar është shkelur ligji në dëm të tij.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të Doganës së Kosovës, të ankimuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, duke konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme ku Sektori i Kontrollit Pas-Importues në arsyetimin e aktvendimit të lartcekur thekson se kishte filluar procedurën e kontrollit pas dokumentar ndaj subjektit "V...F..." Sh.P.K-Gjilan duke kontrolluar librat tregtar, faturat e shitjes dhe pagesat bankare të cilat ishin marrë si dëshmi dhe pas analizimit të tyre ishte hasur në fatura transportit të cilat ishin lëshuar për subjektin ankimor derisa nga gjetjet e këtij Sektori ka rezultuar që subjekti ankimor nuk ka deklaruar drejtë shpenzimet e transportit për 47 ngarkesa dhe për këtë shkak me qëllim të rregullimit të gjendjes sipas detyrës zyrtare kishte ndryshuar të dhënat në DUD-at si në aktvendimin e ankimuar të

Sektorit të Kontrollës Pas-Importuese. Tutje ky Sektori i Kontrollës Pas-Importuese ka obliguar subjektin në procedurë për pagesë shtesë të taksave importuese doganore në kuptim të shpenzimeve të transportit për DUD-at kontestues, për shkak se ka verifikuar në ATK faturat e shpenzimeve të transportit të lëshuara nga kompania transportuese nr. 02216, 02219, 02220, 02230, 02233 etj., dhe si rrjedhojë është konfirmuar se të gjitha faturat e lëshuara nga kompania transportuese janë deklaruar pranë ATK-së, me çka dëshmon fakti se faturat për transport të mallit janë reale në kuptim të vlerës, dhe të njëjtat nuk janë deklaruar nga subjekti në procedure. Gjithashtu janë krahasuar libri i shitjes dhe transferet bankare të transportuesit me transferet bankare të importuesit ku është vërejtur se subjekti nuk i ka deklaruar drejtë shpenzimet e transportit për 47 ngarkesa me c'rast është obliguar me pagesë shtesë. Kolegji i kësaj gjykate, njëjtte si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se subjekti-paditësi nuk ka disponuar me dokumentacion të mjaftueshëm për tu dëshmuar se shuma e paguar e transportit është shumë reale, siç parashihet me nenin 2 pika 3.4 të Udhëzimit Administrativ 04/2014 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara. Dëshmitë e paraqitura në procedurë të rishqyrtimit në organin e paditur dhe në gjykatë të shkallës së parë nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe të harmonizuara për tu deklaruar vlera reale. Andaj, nga këto fakte vlerëson se e paditura, Dogana e Kosovës, me që subjekti nuk ka poseduar dokumentacion të mjaftueshëm në kuptim të vlerës së shpenzimeve të transportit sipas DUD-ave kontestues, si dhe çmimet e prezantuara nga subjekti kanë qenë shumë të ulëta në kundërshtim me UA nr.06/2015. Andaj, nga këto fakte kolegji, vlerëson se e paditura Dogana e Kosovës, me të drejtë ka refuzuar ankesën e paditësit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara.

Pretendimet ankimore të ankuesit se nuk është bërë vërtetim i drejtë i gjendjes faktike dhe provave të prezantuara, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Dhoma e Shkallës së dytë vlerëson se gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji po ashtu vlerëson se dëshmitë në të

cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk kanë ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.981/22, me datë 04.04.2023

**Kryetar i kolegjit,  
Franciska Zhitja Ymeri**